



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr. \_\_\_\_prot.

Tiranë, më. \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM  
TE MARREVESHJES KUADER  
ME OBJEKT PROKURIMI: BLERJE “DRURE DHE SHKURRE”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “DRURE DHE SHKURRE” *Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)**

- produkte drusore 03400000-4
- shkurre 03451300-9

**Vlera e Fondit Limit është: 43, 296,567** (dyzet e tremilion e dyqind e nentedhete e gjashtemije e peseqind e gjashtedhete e shtate) **lekë pa TVSH** ose 437 737 (katerqind e tridhete e shtate mije e shtateqind e tridhete e shtate) Euro pa tvsh referuar kursit te kembimit te Bankes se Shqiperise date 26.09.2024 (**1 euro = 98.91 ALL**).

“Procedurë e hapur ” mbi kufirin e larte monetar, me mjete elektronike.

I mbajtur sot më date **26.09.2024** në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, , për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur mbi kufirin e larte monetar» , me mjete elektronike, duke gjetur zbatim referuar nenit 42 pika 4 e Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik dhe neneve 40, 47 e VKM nr. 285 date 19.05.2021 «Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik» , me afat **24** muaj nga data e lidhjes se kontrates.

**Sasia e mallit dhe grafiku i ekzekutimit;**

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia	Destinacioni	Afati i ekzekutimit
	<b>Baza materiale</b>				
	<b>A. Drure gjetherenes</b>				
1	Bli, ( <i>Tilia platyphyllos</i> ), (me perimeter 15-17 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	300	DPPGJ	24 MUAJ
2	Kumbull e Kuqe, ( <i>Prunus Pissardi</i> ), (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	80	DPPGJ	24 MUAJ
3	Panje, ( <i>Acer pseudoplatanus</i> ), (me perimeter 20-25 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	50	DPPGJ	24 MUAJ
4	Verri, ( <i>Alnus glutinosa</i> ), (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	120	DPPGJ	24 MUAJ
5	Likuidamber, ( <i>Liquidambar styraciflua</i> ), (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	220	DPPGJ	24 MUAJ
6	Shkoze, ( <i>Carpinus betulus</i> ), (me perimeter 14-18 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	320	DPPGJ	24 MUAJ
7	Carac, ( <i>Celtis australis</i> ), (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	40	DPPGJ	24 MUAJ
8	Mimoze, ( <i>Acacia Dealbata</i> ), (me perimeter 10-12 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	95	DPPGJ	24 MUAJ
9	Frasher, ( <i>Fraxinus angustifolia Vahl</i> ), (me perimeter 14-18 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	40	DPPGJ	24 MUAJ
	<b>B. Drure perhereblerte</b>			DPPGJ	24 MUAJ
10	Fotinia ( <i>Photinia fraseri</i> ) (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	200	DPPGJ	24 MUAJ
11	Selvi, ( <i>Cupressus Arizonika</i> ), h=3 m	cope	100	DPPGJ	24 MUAJ
12	Manjole, ( <i>Magnolia grandiflora</i> ), (me perimeter 14-16 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	180	DPPGJ	24 MUAJ
13	Lejlander, ( <i>Cupressocuparis leylandii</i> ), h=2.5-3 m	cope	250	DPPGJ	24 MUAJ
14	Lejlander, ( <i>Cupressus arizonica Variegata</i> ), h=2.5-3 m	cope	250	DPPGJ	24 MUAJ
15	Dafine, ( <i>Laurus Nobilis</i> ), me perimeter 12-14 cm ne 1.3 m nga toka	cope	170	DPPGJ	24 MUAJ
	<b>C. SHKURRE</b>			DPPGJ	24 MUAJ
16	Buxus ( <i>Buxus sempervirens</i> ) h=40-60 cm	cope	3500	DPPGJ	24 MUAJ
17	Oleander ( <i>Nerium oleander</i> ) h=80-100 cm	cope	6200	DPPGJ	24 MUAJ
18	Nandina ( <i>Nandina domestica</i> ) h=40-60 cm	cope	3650	DPPGJ	24 MUAJ

19	Evonimus (Fshikakuqi Japonez) (Euonymus Japonicus) h=40-60 cm	cope	3750	DPPGJ	24 MUAJ
20	Ligustër (Ligustrum vulgare ), (me perimenter 16-18 cm ne 1.3 m nga toka)	cope	220	DPPGJ	24 MUAJ
21	Fotinia (Photinia fraseri) h=40-60 cm	cope	3400	DPPGJ	24 MUAJ

**Afatet e lëvrimit: 24 (njetzet e kater) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër (mini-kontratave pjesë e marrëveshjes kuadër) dhe në sasi dhe kohë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.**

Autoriteti Kontraktor kërkon që për çdo mini-kontratë të nënshkruar brenda marrëveshjes kuadër midis palëve, sasia të vendoset në referencë të kërkesave të AK.

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “DPPGJ” sh.a. ka vendosur që kjo procedurë të mos jetë në lotë sipas arsyetimit të mëposhtem:**

Kjo kontratë nuk është ndare në lotë pasi administrimi i saj do të bëhet nga DPPGJ si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga vetë DPPGJ, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim.(bashkelidhur në SPE edhe procesverbal i mosndarjes në lotë)

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE;**

#### **Bimësia dekorative (drurë\_shkurre) dhe kompozimi në gjelbërim.**

Në sipërfaqet e gjelbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative që ka në përbërjen e saj drurët, shkurret, lulet dhe elementët e tjerë plotësues të gjelbërimit si, koshat për hedhjen e mbeturinave të çastit, stolat për pushim, shatërvane dhe çezma për freskim brenda këtyre sipërfaqeve.

Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund të jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.

#### **Veçoritë e drurëve dekorativë:**

- drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekën, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.
- drurë me kurorë të rrumbullakët; Panja, Gështenja e Kalit, Katabla, Plepi, Shelgu etj.
- drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.
- drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ah, Verri, etj.
- drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.
- drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.
- drurë me kurorë konike; Bredhat, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi, Selvi e Kënetave, etj.
- drurë me kurorë vajtuese; Shelgu vajtues.

Megjithatë drurët në përgjithësi i kanë gjetet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëlllojtë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.

**Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:**

- Drurë me gjethe jeshile të errëta, që ne vjeshta kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i kuq, Blinjte, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethe jeshile të qelta, që ne vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofra, panja negundo, rrapi etj.
- Drurë me gjethe bojqëqielli në jeshile që ne vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.
- Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

### **Veçori të shkurreve dekorative**

Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.

Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj.

Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor.

Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.

Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë (pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:

- a) Qëllimi i mbjelljeve,
- b) Kushtet e mjedisit dhe
- c) Veçoritë biologjike të llojit.

Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.

Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 1,5 deri 2.5m, lartësia e kurorës rreth 2 m, perimetri (cirkoferenca) në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 14 deri 16 cm, kurora të jetë simetrike në formën karakteristike të llojit me buke dheu.

Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në fuksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.

Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.

Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblerë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.

### **TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË**

Në krijimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundur efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur. Kjo teknikë presupozon mbjelljen e bimësisë dekorative më parë nga fidanishtja në vazë.

Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;

○ si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;

○ si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevardë, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore, etj.

Para se të fillojme mbjelljen e pemëve në vazo, në fund të saj duhet të vendosim gurë, guralecë ose qeramikë të thyer për të parandaluar bllokimin e vrimave me dhe' dhe për të lejuar kullimin e lirë. Më pas brenda vazos hidhet toka, kjo duhet të sigurojë ajrim dhe kullim të mjaftueshëm duke ruajtur sasi të përshtatshme lagështie. Për qëllime të përgjithshme do t'i sigurojë të gjitha këto dhe mund të plotësohet edhe me plehra organike. Pema e mbjellë në këtë vazo nuk është në gjendje t'i përhapë rrënjët e saj për të arritur ujin, prandaj është e domosdoshme ta ujisim pemën rregullisht. Në këtë rast uji i freskët i shiut është më i miri.

Nëse jemi të detyruar që pemën nuk mund ta mbjellim në tokë brenda vitit por do ta mbajmë më shumë, atëherë duhet të sigurohuni që pema të jetojë në rehati duke rifreskuar shtratin e saj çdo vit. Këtë veprim mund ta bëjmë duke hequr dheun e sipërm të lirshëm dhe duke e zëvendësuar atë me dhe' të pasur me pleh.

Epërsitë e kesaj metode janë

- Zënie e garantuar dhe zhvillim normal i procesit jetësor të drurëve dhe shkurreve.
- Transport i lehtë dhe i shpejtë në objektet e mbjelljes.
- Heqje e shpejtë dhe mbjellje e lehtë e bimësisë dekorative në gropat e hapura më parë.

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

## **SHKULJA E DRURËVE**

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trungu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.

## **TRANSPORTIMI I DRURËVE**

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinç. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.

Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocerisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisat për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulet, transportohen e mbillen kur temperatura zbrit në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po ne atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

## **MBJELLJA E DRURËVE**

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 5 cm dhe bukë dheu 50 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri\_pema) vendoset përpjendikularisht, 30-40 cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjshet me këmbë, si në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe' rreth e përçark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri\_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.

Per objektin ne reference.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, DPPGJ, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 9*)

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikun e lëvritit të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare vjetore e të cilës të jetë **jo më e vogël se 40%** e vleres se parashikuar te kontrates

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,të ndryshuar, ku parashikohet se: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose loti , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e*

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr.710 datë 24.11.2021

*prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: “1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”<sup>2</sup>”

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023)**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse kërkohe bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, nenit 19 të VKM nr. 498 datë 01.08.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe pikës c) të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

<sup>2</sup> Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021



*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit ne fazen e ofertimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

**Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, janë argumentuar nga grupi i punës i ngritur me Urdher Nr. 530 Prot date 20.09.2024, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit, fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:**

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më pak se 40%** vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a.** Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku të shënohen datat, **shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**
- b.** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, **shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

### ***Plotësimi i një prej kriterit të mësipërm e bën ofertën e kualifikueshme***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.*

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operator ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për periudhën e kërkuar:

- 1 (nje) Inxhinier Agronom

*Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatores Ekonomike duhet të paraqesin diplome, kontratat e punës (te vlefshme brenda afatit të vlefshmerisë së ofertes), cv, dhe libereze pune.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 40, pika 5 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit” .

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për 1 (nje) Inxhinier Agronom lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të*

*kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin’.*

**2.3.3** Një punësim mesatar i të paktën **25 personave**, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin’.*

---

**Argumentimi:** Kërkesa e AK është e bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Bazuar në ‘Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë’ si dhe ‘Vendim Nr. 1025, Datë 16.12.2020 Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi’.

Numri I punonjësve është për caktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sakohë që ato janë në për pjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në për pjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues I kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme). (Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 14001 – 2015** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme). (Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 45001-2018** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Ne rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).

**Shënim:** Certifikatat e mesiperme duhet të jene të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar nën 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot, date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të kontrates.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit (e vlefshme):

- Licencë, Kodi III.7.A për ”Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat ”QKL”.
- Licence, Kodi III.2.A për ”Vleresim i ndikimit në mjedis”.

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nën 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si dhe nën 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nën ligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”,

**2.3.6 Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Kamion me vinc	copë	1	Pronesi/Qera

2	Kamioncine	copë	2	Pronesi/Qera
3	Fadrome me goma	copë	2	Pronesi/Qera
4	Autobot uji	copë	3	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë e kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Mjetet me qira shoqërohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronësise së qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerave të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve ( e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).
- Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe foto.
- Për mjetet me qera, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik ,siguracionin e mjetit,(te vlefshme) dhe foto duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të beje deklarin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre

**Argumentim:** Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës dergimin e mallit sipas sasise se kerkuar ne menyre periodike duke qene se eshte marreveshje kuader nga AK.

Kerkesa lidhet ngushte me distancat dhe me nevoje e AK per tu furnizuar, eshte e nevojshme disponimi i mjeteve deri ne realizimin e plote te kontrates

Eshte ne te drejten e Autoritetit Kontraktor te kerkoje garanci per realizimi me sukses te kontrates, duke perfshire kerkesat per mjetet të cilat nevojiten për kryerjen e shërbimit.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon ambjent mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte) me sipërfaqe **mbi 5,000 (m<sup>2</sup>)** me kushte optimale të furnizimit me ujë dhe plehërimit për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet paraqese dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramartjen si dhe foto te ambjentit te magazinimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosuar për të provuar se OE ka eksperiencë në fushën e tregtimit të objektit ne fjale dhe ka kapacitetet e domosdoshme për përmbushjen e kontratës.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike, kriteret dhe perlllogaritja e fondit limit, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punes miratuar nga titullari i AK, bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika

38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, , nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar

### **Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:**

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
  - b) *studimit me anë të testimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ofertat e marra nga ky studim; ose/dhe*
  - c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
  - ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*
- ***Sa i përket respektimit të pikës “a”,***Instituti i Statistikave “**INSTAT**” nuk disponon çmime të botuara për këtë lloj procedure.
  - ***Sa i përket respektimit të pikës “b”,*** Grupi i Punës, bazuar në rregullat e Prokurimit Publik, kërkoi me anë të “fjesave për ofertë” nga e-mail zyrtar i DPPGJ, oferta nga operatorë ekonomik me të njëjtën objekt veprimi si malli i kërkuar . Këto janë subjekte tregtare të liçensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara **në faqet on-line** respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushën objekt prokurimi.
  - ***Sa i përket respektimit të pikës “c”, dhe ”d”*** Grupi i Punës, bazuar në rregullat e Prokurimit Publik, mendoi se çmimet e kontratave parardhëse janë larg çmimit real të tregut, pasi inflacioni, pagat dhe çmimet kanë pësuar ndryshime.

Nga sa më sipër grupi i punës ka analizuar çmimet e 3 (tre) operatorëve ekonomik duke iu referuar. nenin 76 germa b të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

***b) studimit me anë të testimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ofertat e marra nga ky studim;***

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**